	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 1 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sht.p
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
 OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRZIŠTA KOSTT d.d
 Nr. 500 Dt. 19/05/2017
 PRISHTINË-A


RREGULLORE PËR SHFRYTËZIMIN E PËRBASHKËT TË INFRASTRUKTURËS ALTERNATIVE (PASIVE/FIBER OPTIKE)

Vendimi – 170419/II-5

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 85/17 të datës 19 prill 2017 njëzëri miratoi Rregulloren për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fijeve optike).


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nagip Syla	Mustafë Hasani	Bordi i Drejtorëve
Nënshkrimi			
Data	11 Prill, 2017		



	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 2 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Qëllimi	4
3. Fushëveprimi	4
4. Definicionet	4
5. Kërkesat minimale dhe udhëzimet	5
5.1. Kërkesat themelore	5
5.2. Parimet e përgjithshme	6
5.3. Kushtet teknike	7
5.4. Aspekti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	8
6. Përcaktimi i çmimit dhe marketing	9
6.1.1. Marketingu	9
6.1.2. Komunikimet.....	9
6.1.3. Hulumtimi i tregut.....	9
6.2. Parimet themelore në përcaktimin e çmimit	9
6.3. Metodologjitë për përcaktimin e çmimit	10
6.3.1. Përcaktimi i Çmimit Final Unik	10
6.4. Marrëveshjet kontraktuale dhe afatet kohore	11
6.5. Ofertimi	11
6.6. Marrëveshja/Kontrata	11
6.6.1. Dispozitat e përgjithshme	11
6.7. Procesi bazë dhe koha e shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës	11
6.7.1. Procesi themelorë i kërkesës	12
6.7.2. Afatet kohore	12
6.8. Hyrja në fuqi e Rregullores	13
6.9. Procedurat në rast të mos pagesës së faturave	14
6.10. Financat dhe kontabiliteti	14
7. Përgjegjësitë	15
7.1. Interpretimi	15
7.2. Komunikimi	16
7.3. Arovimi	16
8. Formularët/dokumentet	16
8.1. Burimet	16
8.2. Dokumentet dhe formularët	16
ANEKSET	17
8.3. Lista e shpërndarjes	17
8.4. Shënimet për versionet	17

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 3 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

1. Hyrje

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Telekomunikacion Nr.2002/7, i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-085, janë krijuar kushtet për liberalizimin e tregut të telekomunikimeve në Kosovë.

Ndërkaq, Rregullorja e ART për ‘Të drejtën për shteg dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës’ po inkurajon shfrytëzimin më efikas dhe më ekonomik të infrastrukturës ekzistuese telekomunikuese dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve.

Në përkrahje të këtyre iniciativave, KOSTT-i është angazhuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepricën e kapaciteteve fibër optike.

Si rezultat i angazhimit, në fund të vitit 2013, KOSTT-it iu lëshua Autorizimi / licenca për Operimin e shërbimeve të infrastrukturës, nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ARKEP. Prandaj, kjo veprimtari dhe çdo marrëdhënie juridike apo mosmarrëveshje sipas kësaj rregullore do të trajtohet sipas ligjeve të Republikës së Kosovës .

Në pajtim me obligimet licencore KOSTT ka pranuar nga ZRRë pëlqimin për dhënien në shfrytëzim të kapaciteteve të qasshme të infrastrukturës.

Tani, sipas Rexhimit të Autorizimit të Përgjithshëm, në përputhje me dispozitat e Nenit 16 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike dhe Rregullores Nr.25 për Autorizimet e Përgjithshme (ref. ARKEP nr. prot.015/B/14) dhe Vendimit Nr.581(ref. ARKEP nr. prot. 002/B/15), KOSTT është regjistruar në Regjistrin e Ndërmarrjeve për:


Ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike

Kjo Rregullore është përpiluar bazuar në aktivitetet e përshkruara më lartë dhe bazuar në dokumentet e përpiluara dhe të dorëzuara nga këto aktivitete.

2. Qëllimi

Me anë të kësaj rregullore synohet të definohen kushtet e përgjithshme dhe të jepen udhëzime për ofrim në shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike), në bazë të kërkesës së operatorëve të licencuar, me qëllim:

- Të minimizimit të ndikimit negativ në Operimin e Sistemit të Transmisionit dhe të uljes së besueshmërisë, me ofrimin e infrastrukturës fibër optike;
- Të maksimizimit të shfrytëzimit të elementeve të rrjetit, duke përfshirë por jo kufizuar, kapacitetin dhe aftësitë e rrjetit, nyjet e stacioneve bazë, shtyllat, etj.;

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 4 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

- Të përcaktimit të çmimit unik për qasje në infrastrukturën fibër optike dhe publikimit të tij në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese;
- Të lehtësimit të ofrimit të shërbimeve të infrastrukturës, procesit të negocimit dhe lidhjes së marrëveshjes/kontratës me palët kërkuese të shërbimeve të tilla.

3. Fushëveprimi


Kjo Rregullore i referohet shfrytëzimit të përbashkët të Infrastrukturës Alternative (pasive/fibër optike), siç është definuar në tekstin në vijim.

4. Definicionet

- a) **Infrastruktura e komunikimeve elektronike:** çdo lloj i elementeve përbërëse të rrjetit, duke përfshirë pajisjet komutuese, harduerike dhe softuerike, terminalët dhe linjat, të cilat mundësojnë realizimin e komunikimit nga ose përmes tyre; c)
- b) **Infrastruktura Alternative:** paraqet të gjitha infrastrukturat tjera me përjashtim të infrastrukturës për komunikime elektronike, përmes së cilave ofrohen shërbime të ndryshme;
- c) **Operator/Ofrues të rrjeteve të komunikimeve elektronike:** paraqet një ndërmarrje/entitet ligjor i cili është i autorizuar për të ofruar rrjete të komunikimeve elektronike;
- d) **Operator/Kërkues i rrjeteve të komunikimeve elektronike:** paraqet një ndërmarrje/entitet ligjor i cili dëshiron të lidhë marrëveshje me një tjetër operator të telekomunikacionit apo ofrues të shërbimit, i cili zotëron ose është në kontroll të infrastrukturës dhe pajisjeve të telekomunikacionit, me qëllim të shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës.
- e) **Shfrytëzimi i përbashkët i Infrastrukturës:** Nënkupton përdorimin dhe ndarjen e objekteve dhe pajisjeve të përdorura për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga operatorët tjerë;

5. Kërkesat minimale dhe udhëzimet

5.1. Kërkesat themelore

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 5 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Telekomunikacion, nëse për këtë ekziston mundësia, KOSTT-i nuk do të refuzojë, pengojë ose në ndonjë mënyrë tjetër ti pamundësojë, kërkuesit të licencuar, lidhjen e ndonjë marrëveshjeje për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës.


KOSTT si ofrues i infrastrukturës nuk do të negociojë apo propozojë lidhjen e ndonjë marrëveshjeje për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës, nëse konstatohet se:

- a) Shfrytëzimi i përbashkët i infrastrukturës do të rrezikojë jetën apo sigurinë, ose të shkaktojë dëme të pariparueshme të pronës apo të kërcënojë integritetin, sigurinë ose operimin e rrjetit të telekomunikacionit apo të shërbimeve të tij;
- b) Licenca e lëshuar nga ARKEP e përjashton atë nga detyrimi për të siguruar apo ofruar shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës;
- c) Kërkuesi i infrastrukturës nuk ka licencë/autorizim të operojë me rrjetin e telekomunikacionit ose për të dhënë shërbime telekomunikuese, për të cilat kërkohet shfrytëzimi i përbashkët i infrastrukturës; ose
- d) Shfrytëzimi i përbashkët i kërkuar i infrastrukturës është në kundërshtim me ligjet e Kosovës apo të interesit publik.

KOSTT si ofrues i infrastrukturës, nuk do të refuzojë për të siguruar apo ofruar shërbimet për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, me përjashtim në rastet kur:

- a) Nuk është ekonomikisht e arsyeshme për të lejuar një shfrytëzim të tillë;
- b) Ekziston mundësia e shkakimit të dëmit natyror ose në funksionin e infrastrukturës së tillë;
- c) Është i nevojshëm ndonjë ndërtim apo konstruksion më i madh shtesë;
- d) Nëse shkaqet tjera teknike mund të rrezikojnë infrastrukturën ekzistuese telekomunikuese.


Marrëveshjet për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës duhet të lidhen, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se afatet kohore të përcaktuara me këtë Rregullore, nëse ndërmjet palëve nuk bihet dakord ndryshe.

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 6 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

5.2. Parimet e përgjithshme

Parimet e përgjithshme dhe udhëzimet e përshtetura në tekstin në vijim, do të zbatohen në procesin e ofrimit të shërbimeve për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës:

- a) Veprimtaria primare e KOSTT është operimi i sistemit elektroenergetik, operimi i tregut të energjisë dhe transmetimi i energjisë elektrike, prandaj në çfarëdo rrethane, normat ligjore dhe teknike të ligjeve përkatëse për energjinë do të kenë përparësi për KOSTT.
- b) KOSTT ka për obligim të trajtoj kërkesat, të lidh marrëveshjet dhe të ofroj shërbime për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, në frymën e mirëbesimit me kërkuuesin e shërbimeve;
- c) Në përputhje me ligjin, KOSTT duhet, në radhë të parë, të bëjë përpjekje për të arritur marrëveshje për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës me anë të negociatave. Me qëllim të parandalimit të dështimit të negociatave dhe për të përshpejtuar përfundimin e tyre, duhet të ndiqen këto udhëzime. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje, palët negociuese mund ta drejtojnë çështjen në ARKEP, për gjetjen e zgjidhjes;
- d) Shërbimet për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, do të sigurohen vetëm nga ato pika dhe shtigje të cilat janë teknikisht të mundshme dhe i nënshtrohen kontrollit të plotë nga ana e KOSTT-it. Ato shërbime do të ofrohen vetëm sipas termave dhe kushteve të arsyeshme dhe jo diskriminuese dhe në përputhje me një marrëveshjen për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës me palën;
- e) KOSTT-i do të përgatisë një listë të pikave të mundshme dhe skemën e rrjetit, të përshtatshëm për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës.
- f) Shërbimet për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, për kërkuuesit, do të ofrohen me çmime të arsyeshme, sipas kushteve dhe kualitetit, të cilat janë jo më pak të favorshme se ato që janë në shfrytëzim për nevoja vetanake;
- g) Çmimet për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës do të përcaktohen në bazë të vlerësimit të kushteve të tregut dhe interesit ekonomik të KOSTT-it;

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 7 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

- h) Kostot dhe tarifat do të jenë të ndara në atë mënyrë, që kërkuesi i infrastrukturës të jetë i obliguar të paguajë vetëm për elementet e rrjetit ose të shërbimeve për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës të cilat i ka kërkuar;
- i) Çmimet për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, do të jenë të bazuara në kosto dhe do të vendosen në atë mënyrë që KOSTT-it ti mundësojnë rimarrjen e një norme të arsyeshme të kthimit të kapitalit të investuar, duke mbuluar të gjitha shpenzimet operative që i takojnë dhe amortizimin dhe njëkohësisht të janë kontribut proporcional për mbulimin e shpenzimeve fikse dhe ato të përbashkëta;
- j) Shfrytëzuesi i fijeve optike nuk mund të jep me nën-qira fijet optike të marra në shfrytëzim nga KOSTT.

5.3. Kushtet teknike


Kushti i parë për ofrimin për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, operatorëve të licencuar, është fakti se shfrytëzimi i përbashkët i aseteve ende të pashfrytëzuara nuk do të rrezikoj veprimtarinë themelore të KOSTT-it:

- Duke mos i zënë kapacitetet e lira, të cilat janë potencialisht të nevojshme, për shërbimet themelore brenda KOSTT-it;
- Duke mos lejuar asnjë interferencë, gjatë shfrytëzimit të kapaciteteve të lira nga ana e operatorëve të licencuar, me shërbimet e përdorura nga ana e KOSTT-it.

Për të shmangur dilemat rreth asaj që u tha më lartë, KOSTT-i do të përdor një rregull të thjeshtë, që mos ti ofroj për shfrytëzim të përbashkët, më shumë se gjysmën e fijeve optike, duke konsideruar edhe kufizimin e dhënies në shfrytëzim si sasi të kufizuar në kuptimin e krijimit të kushteve për ofrim të këtyre kapaciteteve, për të gjitha ofertat e arsyeshme.

KOSTT do të jetë përgjegjës për instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit fibër optik të vetë: kablllove, shtyllave, kanaleve, kutive lidhëse etj. për nevoja të veta, por KOSTT nuk merr përsipër asnjë lloj përgjegjësie për riparimin apo mirëmbajtjen e pajisjeve të kyçjes apo çfarëdolloj pajisje tjetër të shfrytëzuesit të fijeve optike.

KOSTT nuk garanton dispionueshmërinë e fijeve optike dhe nuk mban përgjegjësi për çfarëdolloj humbje të shfrytëzuesit në rast të fuqisë madhore, apo dëmtimeve të cilat shkaktohen nga palët e treta përtej kontrollit të KOSTT, apo në rastet tjera kur KOSTT për shkak të rrethanave mbisunduese të cilat ndërlihen me sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe përmbushjes së obligimeve kontraktuale dhe normave teknike të ENTSO-E nuk është në gjendje të eliminoj defektet në kohë të caktuar.

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 8 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

Në këto raste koha e mungesës së disponueshmërisë së fijeve optike do të evidentohet nga KOSTT, dhe për të njëjtën kohëzgjatje shfrytëzuesit do t'i ofrohet zgjatje e kohës së shfrytëzimit të fijeve apo mungesa e tillë e disponueshmërisë do të zbritet nga pagesa mujore/vjetore proporcionalisht me çmimin e kontraktuar të shfrytëzimit dhe kohën e mungesës.

Klientët e KOSTT-it do të jenë përgjegjës për instalimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha kabllove dhe pajisjeve, nga ambientet e veta deri tek kabineti i shërbimit apo lidhjes në ambientet e KOSTT-it. Rrjeti fibër optik i KOSTT-it dhe përbërësit e tij mbesin pronë e KOSTT-it në mënyrë permanente. Klientët e KOSTT-it mbajnë përgjegjësinë për çdo dëm të shkaktuar në rrjet apo fije optike të KOSTT-it.


5.4. Aspekti i Mbrojtjes dhe Sigurisë

Qëndrimi dhe kryerja e punimeve në afërsi të stabilimenteve elektroenergjetike gjithnjë paraqet rrezik për shëndetin dhe jetën e njeriut. Andaj, me qëllim të parandalimit të rrezikut në vendet ku kryhen punimet, duhet të merren masa parandaluese dhe mbrojtëse, si nga ata që punojnë në kudër të këtyre stabilimenteve ashtu edhe nga ata që i shfrytëzojnë lidhjet fibër optike:

- Para se të hynë në nënstacion për të kryer ndonjë punë, kompania kontraktuese dhe stafi i saj, duhet të nënshkruajnë një formular aplikimi që konfirmon se ata i kanë lexuar dhe kuptuar udhëzimet ekzistuese të mbrojtjes dhe sigurisë të KOSTT-it.
- Bazuar në këtë, ata (kompania, si dhe çdo person, punëtor në atë kompani apo për atë kompani) do të marrin një leje për punë si (nën) kontraktorë.

Ka disa aspekte të sigurisë që duhen konsideruar gjatë shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës:

- Në rast të punimeve në lartësi dhe në afërsi të linjave të tensionit të lartë (shtylla) ose pajisjeve të tensionit të lartë, punët mund të kryhen vetëm nga personeli i autorizuar i KOSTT-it.
- Midis fijeve të ndryshme optike në të njëjtin kabëll nuk ka influencë apo interferencë. Kjo do të thotë se rrjedha e informatave në një palë fibra nuk ndikon në rrjedhën e informatave në palën tjetër.
- E vetmja mundësi për ndikim në shërbimet e brendshme të KOSTT-it mund të paraqitet në momentin e lidhjes së shfrytëzuesve të jashtëm në rrjetin optik të

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 9 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

- KOSTT-it. Për këtë arsye, prania e personelit të KOSTT-it, është e domosdoshme dhe gjithnjë në përputhje me rregulloret e brendshme të KOSTT-it.
- Instalimi i një lidhje fibër optike në rrjetin e KOSTT-it duhet të kryhet në përputhje me kërkesat/ rregullat e rrjetit fibër optik të KOSTT-it.
 - KOSTT nuk merr asnjë lloj përgjegjësie për sigurinë dhe shëndetin e personave të autorizuar të shfrytëzuesit të shërbimeve, të cilët kryejnë punë sipas këtij seksioni.

6. Përcaktimi i çmimit dhe marketingu

6.1. Marketingu

Aktivitetet në fushën e marketingut mund të ndahet në: komunikime dhe hulumtim të tregut.

6.1.1. Komunikimet

Është shumë e rëndësishme që në mënyrë efektive të përdoren teknologjitë e reja dhe mediat për qëllime komunikimi. Që nga fillimi, mundësitë e gjera që ofron komunikimi përmes internetit dhe mediave sociale, do të merren parasysh në komunikimet për marketing.

Andaj, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pranisë së shërbimeve telekomunikuese në web faqen e KOSTT-it në internet. Të gjitha format e kontaktimit do të gjinden në faqen elektronike të KOSTT-it, përkatësisht në linkun për Shfrytëzimin e Përbashkët të Infrastrukturës Alternative (Pasive /Fibër Optike), si dhe në Broshurat aktuale.


Broshura është një nga materialet shumë të rëndësishme të marketingut që duhet përgatitur. Ajo duhet të përfshijë ofertat aktuale dhe si e tillë të publikohet edhe në web faqen e KOSTT-it në internet apo edhe të shpërndahet në formë të materialit të printuar.

6.1.2. Hulumtimi i tregut

Aktivitet kryesor në hulumtimin e tregut do të jetë analiza për përcaktimin e çmimit për shërbime telekomunikuese, ndërsa analiza e kërkesave në treg, analiza e konkurrencës etj. përbëjnë komponentë të rëndësishme në hulumtimin e tregut.

6.2. Parimet themelore në përcaktimin e çmimit

Tarifat për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës duhet të jenë:

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 10 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

- a) Të përcaktuara në mënyrë transparente, duke iu nënshtruar çdo kërkesë për konfidencialitet, për të cilën ARKEP ka për të rënë dakord; për të siguruar transparencën, detajet se si janë përcaktuar tarifat për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës, mund të zbulohen me kërkesën e ARKEP-it;
- b) Jo-diskriminuese, duke siguruar që KOSTT si ofrues i infrastrukturës, aplikon kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ofrimin e shërbimeve ekuivalente, për të gjitha palët e interesuara (kërkuesit e infrastrukturës), ashtu siç i ofron për vete;
- c) Reciproke për të njëjtin shërbim, në mënyrë që ofruesi infrastrukturës dhe kërkuesi i infrastrukturës, të paguajnë të njëjtin çmim për ofrimin e shërbimit të njëjtë ndaj njëri tjetrit, me përjashtim të ndonjë kontributi të aplikueshëm ndaj një deficiti në qasje, i cili mund të miratohet nga ARKEP;
- d) Preferohet që kostot jo periodike të kompensohen përmes pagesave jo të përsëritura, ndërsa kostot periodike të kompensohen përmes pagesave të përsëritura;


6.3. Metodologjitë për përcaktimin e çmimit

6.3.1. Përcaktimi i Çmimit Final Unik

Bazuar në rezultatet e strategjive të propozuara të çmimeve, të ofruara nga këshilltarët profesional, është përpiluar dokumenti **DT-OS-036 Metodologjia për përcaktimin e çmimit për dhënie në shfrytëzim të fibrave optik**, me qëllim të përcaktimit të **Çmimi Final**, të cilin KOSTT-i do ta aplikojë dhe publikoj, për ofrimin e linçeve fibër optike:

Çmim Final Unik, për Km / Vit	Kërkesa për: 1 Palë fibra (2 fije)	Kërkesa për: 1 fibër (1 fije)
Për ofrimin e linçeve fibër optike në përgjithësi	504 €	252 €

Ky çmim është përcaktuar në atë mënyrë që të arrihet një **Çmim Final Unik**, në mes të çmimeve nacionale dhe atyre internacionale, pa marrë parasysh marrëveshjet afatgjata dhe volumin.

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 11 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

Me qëllim të lehtësimit të llogaritjes, në tabelën në vijim, është dhënë **Çmimi Final Unik**, por tani për **Km / Muaj** :

Çmim Final Unik, për Km / Muaj	Kërkesa për: 1 Palë fibra (2 fije)	Kërkesa për: 1 fibër (1 fije)
Për ofrimin e linçeve fibër optike në përgjithësi	42 €	21 €

6.4. Marrëveshjet kontraktuale dhe afatet kohore

6.5. Ofertimi

Para se të jap ofertën për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës alternative, fibër optike, KOSTT-i do të publikoj Ftesën për shprehje të interesit, për të gjithë operatorët e licencuar dhe të interesuar për marrjen e këtyre shërbimeve.

Klienti potencial i KOSTT-it duhet ti përgjigjet ftesës me Kërkesën për marrje të shërbimeve të infrastrukturës të përshkruar në pikën 6.7.1.

6.6. Marrëveshja/Kontrata


6.6.1. Dispozitat e përgjithshme

6.6.1.1. KOSTT si ofrues i infrastrukturës do të përpilojë një Marrëveshje/Kontratë, e cila është në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore dhe Ligjin në fuqi.

6.6.1.2. KOSTT si ofrues i infrastrukturës mund të modifikojë ose të ndryshojë këtë Marrëveshje/Kontratë, sipas nevojës por gjithnjë në përputhje me këtë Rregullore dhe Ligjin në fuqi.

6.7. Procesi bazë dhe koha e shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës

- Kontrata për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës alternative, fibër optike, sipas kësaj Rregullore, mund të lidhet vetëm për periudhën kohore prej 1 (një) deri në 3 (tri) vite.

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 12 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

- Pas skadimit të afatit të kontraktuar, për shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës alternative, fibër optike, mund të ri lidhet një Kontratë e re sipas kushteve të njëjta, apo kushteve tjera për të cilat palët bien dakord.

6.7.1. Procesi themelorë i kërkesës

Kërkesa për marrje të shërbimeve të infrastrukturës duhet të përmbajë të paktën informatat e mëposhtme:

- numrin referent të licencës së kërkuesit të infrastrukturës;
- një përshkrim teknik të shërbimeve të kërkuara;
- lokacionet;
- periudha kohore për të cilën kërkohet lidhja e kontratës; dhe
- afati kohor për zgjidhjen e kërkesës.

Kërkuesi i infrastrukturës do të mbulojë shpenzimet e arsyeshme të bëra KOSTT-i për përpunimin e kërkesës dhe ofrimin dhe shoqërimin gjatë vizitave në terren. Të gjitha shpenzimet duhet të jenë të shënuara në Aneks të kontratës dhe si të tilla t'i referohen shpenzimeve të kyçjes.

6.7.2. Afatet kohore


KOSTT si ofrues i infrastrukturës, do të konfirmojë pranimin e çdo kërkesë, jo më vonë se 3 ditë pune, pas pranimit të kërkesës.

KOSTT si ofrues i infrastrukturës, duhet të marr në konsideratë dhe të analizojë çdo kërkesë dhe të njoftojë kërkuesin e infrastrukturës brenda 14 ditëve kalendarike, nga dita e konfirmimit të pranimit të kërkesës, apo ndonjë periudhë kohore tjetër të rënë dakord mes palëve, për atë se:

- nevojitet plotësimi i mëtejshëm i informatave, për të pasur një kërkesë më të plotë dhe më të saktë; ose
- kërkesa është mjaft e plotë dhe e saktë për të rezultuar me një kontratë.

KOSTT si ofrues i infrastrukturës, duhet të ofroj një marrëveshje/kontratë sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas pranimit të kërkesës për shfrytëzim të fijeve optike.

Nëse KOSTT-i si ofrues i infrastrukturës e refuzon kërkesën, në atë rast duhet të japë arsyet e detajuara me shkrim për refuzim të kërkesës, kërkuesit të infrastrukturës, brenda 20 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së kërkesës së plotë dhe të saktë.

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 13 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

Një kërkesë/kontratë do të përfshihen të gjitha informatat e kërkuara nga kërkuesi i infrastrukturës dhe afatet për marrjen e shërbimeve të kërkuara, duke përfshirë dhe informatat minimale në vijim:

- a) datën e disponueshmërisë;
- b) intervalin e instalimit;
- c) përpunimin e kërkesës dhe shpenzimet e procedimit; dhe
- d) kushtet tjera të nevojshme për aktivizimin e shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës.

Në kontratë do të përcaktohet kërkesa që shfrytëzuesi i infrastrukturës do të ofroj një garanci bankar në formën dhe përmbajtjen e pranueshme nga KOSTT-i, për së paku gjysmën e kohëzgjatjes së kontratës, nga data e fillimit, i cili do të përtërihet një muaj para përfundimit të gjysmës së kohëzgjatjes së kontratës deri në fund të së njëjtës. Ky garanci do të mbuloj pagesat mujore për periudhën e shfrytëzimit të infrastrukturës sipas kontratës dhe këtij paragrafi.

6.8. Hyrja në fuqi e Rregullores


6.8.1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore dhe të Marrëveshjes/Kontratës, të gjitha dispozitat e kësaj Rregullore do të hyjnë në fuqi.

6.8.2. Nëse para hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore kanë ekzistua marrëveshje për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës, nuk do të ketë korrigjime retroaktive të çmimeve të paguara për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës.

6.8.3. Nëse një marrëveshje ekzistuese për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës e mbulon një periudhë kohore edhe pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore dhe të Marrëveshjes/Kontratës, tarifat tashmë të paguara duhet të nivelohen me çmimet maksimale të Kontratës së miratuar që nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore. Ky rregullim i çmimeve mund të bëhet ose nëpërmjet ri-imbursimit ose nëpërmjet kompensimit të diferencës në raport me faturat e marrëveshjeve të ardhshme për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës.

6.9. Procedurat në rast të mos pagesës së faturave

Në rast të mos pagesës së një fature për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës, do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 14 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

6.9.1. Në rast të marrëveshjes së lidhur për herë të parë për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës, qasja në infrastrukturë do të jepet vetëm pas pagesës së plotë të faturës së parë të lëshuar.

6.9.2. Në rast të mos pagesës së faturave të mëvonshme për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- KOSTT-i si ofrues i infrastrukturës, dërgon një lajmërim mujor.
- Pas datës 15 të muajit aktual, jepet një njoftim final dhe kopja dërgohet në ARKEP.

- Në qoftë se pagesa e plotë ende nuk është marrë deri në fund të muajit aktual, KOSTT-i si ofrues i infrastrukturës ka të drejtë për shpëputje ose heqje të pajisjeve të kërkuarit të infrastrukturës nga pika e kyçjes, dhe do të kompensohet në përputhje me dispozitat e përfshira me Marrëveshjen e nënshkruar, dhe inkasimin e shumës/ve mujore të qirasë të mbuluara me garancinë bankar.

6.10. Financat dhe kontabiliteti

Si rezultat i shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës, llogaritë e pa-rregulluara që rrjedhin nga kjo veprimtari duhet të mbahen të ndara nga llogaritë e rregulluara.


Në shkresën e ARKEP, me njoftimin për dhënie të autorizimit për operim me shërbimet e infrastrukturës ceken:

- **Kërkesat për xhirollogari**, ku theksohet:

- *“Nëse i autorizuari ka disa autorizime telekomunikuese, për të cilat atij i është aprovuar kjo paraprakisht me shkrim nga Autoriteti, atëherë brenda gjashtë (6) muajve që nga data e hyrjes në fuqi dhe në vazhdimësi të saj, i autorizuari duhet të siguroj ndarjen e dubur të niveleve organizative dhe atyre të kontabilitetit me qëllim që të lehtësohet ndarja e të hyrave, shpenzimeve dhe çmimeve të shërbimeve individuale të telekomunikacionit që ata kryejnë, si dhe të bëjnë revizionin vjetor të deklaratave financiare bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në bazë të ligjeve të aplikueshme.”*

- **Raportimi financiar**, ku theksohet:

- *“I autorizuari duhet të dorëzoj Autoritetit raportet vjetore duke përfshirë edhe informatat financiare të bazuara në revizionimin (auditimin) e pavarur konform dispozitave të nenit 27 të ligjit për*

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 15 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

komunikimet elektronike dhe Rregullores për Pagesat për Mbikëqyrjen e Tregut të Komunikimeve Elektronike (Rreg. Nr. 18 Nr. Prot. 021/B/13)”.

- *“Raporti financiar duhet të dorëzohet pranë Autoritetit, Brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të vitit kalendarik, respektivisht deri më 31 mars të çdo viti”.*

- **Obligimet financiare**, ku theksohet:

- *“Pagesa (tarifa) e rregullt vjetore për secilin vit kalendarik do përlllogaritet mbi/nga të hyrat vjetore bruto dedikuar aktivitetit të autorizuar, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme”.*

Ndërsa në shkresën (email) e ZRE, ceket se :

“Sigurisht që implikimet e Rregullës janë se pas çdo viti relevant, OST/OT duhet t’i ofrojë Zyrës së Rregullatorit për Energji detajet e këtij shërbimi të ofruar si pjesë e biznesit të transmisionit, si dhe ti deklaroni të hyrat e pranuar nga këto shërbime.

7. Përgjegjësitë

Menaxhmenti i KOSTT-it është përgjegjës për implementimin e kësaj Rregullore.

7.1. Interpretimi

Interpretimin e kësaj Rregullore do ta bëjnë Bordi i Drejtorëve dhe sipas nevojës Sekretari i Kompanisë.

7.2. Komunikimi

Kjo rregullore do të publikohet në portalin e KOSTT-it dhe sipas nevojës edhe në web faqe.

Kjo Rregullore do të komunikohet edhe përmes formave tjera të komunikimit elektronik.

Shkeljet e kësaj Rregullore do të sanksionohen në harmoni me dispozitat nga Politikat përkatëse në KOSTT-it.


7.3. Aprovimi

Kjo Rregullore aprovohet nga Bordi i Drejtorëve me propozimin nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe ndryshimet e saj do të bëhen me procedurë të njëjtë si të aprovimit.

8. Formularët/dokumentet

8.1. Burimet


Nr.	Emri i dokumentit
1.	<i>Operationalization of the infrastructure sharing of KOSTT.pdf</i>

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 16 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

2.	<i>KOSTT_Infrastructure_Sharing_Model_Input_Main_Scenario.xlsm</i>
3.	<i>User's guide _ KOSTT model_.pdf</i>
4.	<i>Sharing_of_KOSTT_infrastructure.docx</i>
5.	<i>Draft_DarkFiber_LeaseAgreement.docx</i>
6.	<i>KOSTT_ProfitAndLoss.xlsx</i>
7.	<i>KOSTTtelecom_BusinessPlan.docx</i>

8.2. Dokumentet dhe formularët

- **FO-OS-068** Ftesë për Shprehje Interesi për huazim të fibrave të errët në rrjetin fibër optik të KOSTT-it
- *Draft_Marrveshja për Ofrim të shërbimeve të linjave me qira (fibra optik të pa-ndriçuar)*
- **DT-OS-036** Metodologjitë e përcaktimit të çmimit për dhënie në shfrytëzim të fibrave optik

	Rregullore për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike)	PO-OS-007
	<i>ver. 3.0</i>	<i>faqe 17 nga 17</i>
<i>Departamenti: Operimi i Sistemit</i>		<i>Sektori: Telekomunikacioni</i>

ANEKSET

8.3. Lista e shpërndarjes

Nr.	Emri dhe mbiemri	Data	Nënshkrimi
1.	Personeli: G:\SMC ISO 9001\OS-Operatori i Sistemit\PO-OS		
2.	Visar Hoxha		
3.	Nagip Syla		
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			

8.4. Shënimet për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohë ruajtja
1.0	07.10.2016	Versioni Inicial	
2.0	23.01.2017	Versioni punues	
3.0	11.04.2017	Versioni Final	